REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 128/17
Datë/Datum. 19.05.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova –Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

REFERENCË:	128/17
PËR:	- Zyrtarin e prokurimit të AK-së- Komuna e Fushë Kosovës - Parashtruesit të ankesës **N.T.P. "UNIVERZAL COMERC"** me seli në Fushë Kosovë
CC:	- Panelit Shqyrtues në OSHP, - Arkivës në OSHP
NGA:	Sabrije Bullatovci, Ekspert shqyrtues i prokurimit Bullatovci
TEMA:	Raporti i vlerësimit të ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar **N.T.P. "UNIVERZAL COMERC"** me seli në Fushë Kosovë, me numër protokollit 128/17, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve zyrtare"** me nr. të prokurimit 612/17/438/221, kundër vendimit të Autoriteti Kontraktues (AK) Komuna e Fushë Kosovës.

Lokacioni:	Prishtinë	Data:	19.05.2017
PËR AKTIVITET			X
SIÇ ËSHTË KËRKUAR			X
PËR KOMENTE			X
PËR INFORMIMIN TUAJ			X

Bazuar në nenin 113 dhe 114 të LPP të Kosovës, ju njoftojmë me raportin e ekspertizën lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve zyrtare"** me nr. të prokurimit 612/17/438/221, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Fushë Kosovës, si dhe me përgjigjen ndaj pretendimeve ankimore të OE ankues **N.T.P. "UNIVERZAL COMERC"** me seli në Fushë Kosovë, me numër protokollit 128/17.

Konform nenit *113 dhe 114*, Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues i pavarur , ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si dhe kërkesën e AK-së, dhe ka konstatuar si më poshtë:

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë,të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues dhe ekspertit teknik.

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bujtatari		10.05.2017		10.05.2017		19.05.2017
Nënshkrimi i ekspertit		*data e autorizimit të eksp.*		*data e fillimit të ekspertizës*		*data e dorëzimit të raportit*

N. 99, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit-

Me datë 27 prill 2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesën e parashtruar nga OE **N.T.P. "UNIVERZAL COMERC"** me seli në Fushë Kosovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve zyrtare"** me nr. të prokurimit 612/17/438/221, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK)–Komuna e Fushë Kosovës.

Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa VIII e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i OSHP-së e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë:

N. 109,-Operatoret Ekonomik Ankues: N.T.P. "UNIVERZAL COMERC" me seli në Fushë Kosovë

Pikat e Ankesës:

- Shkelje e nenit 61 të LPP-së, Tenderët Jo-normalisht të Ulët;
- Shkelje e nenit 4.2 te Rregullat e tendave jo normalisht të ulët, sipas Formularit B57 aprovuar me dt. 07.07.2016 (Versioni i korrigjuar) nga KRPP-ja.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

- Ne si operator ekonomik ofertues në këtë aktivitet të prokurimit me dt. 11.04.2017, ju kemi drejtuar autoritetit kontraktues që te na jep qasje ne dokumentacionin tenderik të operatorëve ekonomik ofertues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- Neve me dt. 12.04.2017, na është lejuar qasja ne dokumentacion tenderik të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit. Pas shqimit të dokumentacionit tenderik të ofertuesve ne e kemi konstatuar se autoriteti kontraktues ne rastin konkret ka vepruar në kundërshtim me nenin 61 të LPP-së dhe nenin 3 Rregullat për Tenderin Jo-Normalisht të Ulët (të aprovuar nga KRPP-ja).
- Operatori i rekomanduar për shpërblim me kontratë "D.P.Z. Suzuki", është i pa përgjegjshëm konform nenit 61 të LPP-së dhe në kundërshtim me nenin 3 lidhur me Rregullat për Tenderin Jo-Normalisht të Ulët të aprovuar nga ana e KRPP-së, sepse i njëjti operator ekonomik për shumë artikuj kryesor ka ofruar çmime abnormalisht të ulët që nuk përkon me çmime reale të tregut dhe njëkohësisht nuk përkojnë me çmime referente të Listës së çmimeve njësia për mirëmbajtjen dhe servisimin e veturave, pjesëve të ndërrimit (pjesëve rezervë) të aprovuar dhe të publikuar nga ana e KRPP-së.

- Ne me dt. 12.04.2017, me qëllim të verifikimit të pretendimeve tona ju kemi drejtuar me kërkesë për interpretim KRPP-së, dhe i njëjti organ me dt. 13.04.2017, përmes interpretimit të tij të dt. 13.04.2017, na ka konfirmuar se operatoret ekonomik të renditur me numër 1, 2 dhe 4 janë të papërgjegjshëm.

  Provë: Interpretimi i KRPP-së.

Procesi i prokurimit

Data e autorizimit të prokurimit nga zyrtari autorizues(N.22.1).....27.02.2017

Data e njoftimit për kontratë(N.40) : 01.03.2017

Lloji i procedurës së aplikuar (N.33-38):-.....Procedurë e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar(N.16): ....Shërbime /e mesme

Vlera e përllogaritur për këtë prokurim (N.15-19): .....124,000.00 €

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë): 23.03.2017

Data e hapjes së ofertave (N.58) -.....23.03.2017

Kriteret për vlerësim

Kriteri për dhënien e kontratës (N.60): .....Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët

***Kërkesat (administrative) për përshtatshmëri* (N.65-69):**

- Përshtatshmëria e OE me kërkesat e nenit 65 të Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

- Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit (duhet të dorëzohet nga tenderuesi që propozohet për dhënie të kontratës -kopje e noterizuar)

- Një vërtetim nga autoriteti kompetent gjyqësor i vendit te themeluesit të tenderuesit (GjTHK) se tenderuesi nuk ka pengesa lidhur me Kërkesat e pershtatshmerise Pika 6.2 .nën a,c,d,e,f dhe pika 6.3 nen a.b. dhe d. të dosjes se tenderit jo me te vjetër se 6 (gjashtë) muaj nga data e fundit te dorëzimit te tenderit (duhet të dorëzohet nga tenderuesi që propozohet për dhënie të kontratës- origjinali ose kopje e noterizuar)

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- Deklarata nën betim e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e Aneksi 2 në dosjen e tenderit
- Vërtetimi i ATK
- Vërtetimi nga Gjykata

Kërkesat përshtatshmërisë profesional (N. 66):

- Regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit (kopje). Operatori Ekonomik ne kuadër te veprimtarive munde te ketë ndonjërën nga veprimtarit shërbyese dhe/ose ndonjërën nga veprimtarit për tregti te ndonjërit nga pozicionet ne specifikimet teknike.
- Certifikata e Numrit Fiskal, nëse nuk është e përfshire ne certifikatën e biznesit (kopje)
- Certifikata për Regjistrim në TVSH e lëshuar nga ATK (kopje)

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- Certifikata e regjistrimit te biznesit, se bashku me dokumentin Informatë mbi Bizneset (kopje).
- Certifikata e numrit Fiskal nëse nuk është e përfshire ne certifikatën e biznesit (kopje).
- Certifikata për Regjistrim në TVSH (kopje

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare (neni 68 të LPP-së)

- Sigurimi tenderit ne vlerë 1,000.00€

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

/

Kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale (neni 69 të LPP-së)

- Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku tri kontrata të natyrës së ngjashme në tri (3) vitet e fundit (2014,2015,2016)
- Operatori Ekonomik duhet të ofroj stafin e nevojshëm që do të angazhohet në këtë projekt.
- Specifikimi i kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës dhe fuqisë tjetër punëtore – dëshmi lista e punëtorëve (min. 4 mekanik - punëtorë).
- Pajisjet e nevojshme për ketë projekt: Vinqa hidraulik për ngritjen e automjeteve-min 4 vinqa,
- Pajisje për riparimin (vullkanizimin)e gomave,
- Pajisje speciale për diagnostifikim kompjuterik,
- Pajisje speciale për riparim dhe (mbushje) të klimave,
- Pajisje për centrimin e dritave të automjeteve,

- Automjet për bartjen (tërheqjen) e automjeteve në rast defekti ne rrugë.
- OE te posedoj hapësirë te mjaftueshme (garazhe) për servisim te automjeteve. Kjo hapësirë duhet te jetë e mbyllur dhe e mbrojtur nga ndikimet e faktorëve te jashtëm siç janë reshjet,era,pluhuri etj min 170 m2 dhe hapësirë përcjellëse –parking te obligueshëm .OE te ketë garazhen jo me larg se 12 km nga objekti i Komunës.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- Një listë të kontratave të realizuar ne tri vitet e fundit duke saktësuar : produktet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit te përcjella me referenca përkatëse ose proceset e pranimeve – kopje.

- Specifikimi i kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës dhe fuqisë tjetër punëtore – dëshmi lista e punëtorëve (min. 4 mekanik - punëtorë).

- Dëshmitë për pajisjet e kërkuara (fotografit ose dokumentacion tjetër dëshmues). Kurse për automjetin për tërheqje dëshmia te behet me leje për qarkullim-kopje

- Dëshmi - vërtetimi i tatimit në prone, fleta poseduese, marrëveshje për qiranë e garazhes ose ndonjë dëshmi tjetër.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike (N.58)

Nr.	Emri i OE	Vendi	Çmimi
1.	Auto Servis "DRAGUSHA"	Bërnicë e Epërme	51, 027.82€
2.	N.T.Sh. "FORDI"	Ferizaj	51, 923.63€
3.	N.T.Sh. "EUROPA"	Prishtinë	252,648.21€
4.	D.P.Z. "SUZUKI"	Miradi e Ulët	49, 818.50€
5.	N.T.P. "UNIVERZAL COMERC"	Vushtrri	92,867.50€

Komisionet vlerësues pran AK

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues (N.74).

Më dt. 28 maj 2017, autoriteti kontraktues, ka caktuar komisionin për vlerësimin e tenderëve në përbërje prej tre (3) anëtarëve, si në vijim:

- Gëzim Shabani- Kryesues
- Zoran Kitič- Anëtar
- Ilir Krasniqi- Anëtar

Data e fillimit dhe mbarimit të vlerësimi:.....11.04.2017

Data e njoftimit për dhënie të kontratës (N.41):.....11.04.2017

Data e vendimit të AK-së mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të OE (N. 108/A):.....20.04.2017

Raporti i komisionit vlerësues

Bazuar në raportin e vlerësimit të tenderëve, komisioni vlerësues konstatoj se 5 (pesë) operatoret ekonomik që kanë ofertuar, ne aktivitetin e prokurimit **"Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve zyrtare"** me nr. të prokurimit 612/17/438/221, të gjithë operatoret ekonomik i plotësojnë kriteret e përzgjedhjes të kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

- OE N.T.Sh. "EUROPA" Prishtinë, është eliminuar pasi që ka ofruar çmim më të lartë se sa buxhetin e paraparë nga autoriteti kontraktues.

Komisioni vlerësues i rekomandon zyrtarit të prokurimit që kryerjen e shërbimeve **"Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve zyrtare"**, ta kryej OE D.P.Z. "SUZUKI" Miradi e Ulët, pasi që ka ofruar çmimin më të ulet dhe është i përgjegjshëm me dokumentacion.

Analiza dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues (N. 113,114)

Sqarimi : Nr. 1

Ekspertja shqyrtues bazuar ne dokumentacioni që ka në shqyrtim konstaton se autoriteti kontraktues në aktivitet të prokurimit **"Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve zyrtare"** me nr. të prokurimit 612/17/438/221, ka aplikuar procedurën e hapur. Lloji i kontratës është kontratë publike kornizë 36 muaj, shërbime, vlerë e mesme. Dosja e tenderit përfshinë termet dhe kushtet materiale të saja, procedurën e zbatueshme të prokurimit, kërkesat të aplikueshme të përshtatshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes.

Sqarimi Nr. 2

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 61 të LPP-së, respektivisht ku ceket: "*Operatori i rekomanduar për shpërblim me kontratë "D.P.Z. Suzuki", është i pa përgjegjshëm konform nenit 61 të LPP-së dhe në kundërshtim me nenin 3 lidhur me Rregullat për Tenderin Jo-Normalisht të Ulët të aprovuar nga ana e KRPP-së, sepse i njëjti operator ekonomik për shumë artikuj kryesor ka ofruar çmime abnormalisht të ulët që nuk përkon me çmime reale të tregut dhe njëkohësisht nuk përkojnë me çmime referente të Listës së çmimeve njësia për mirëmbajtjen dhe servisimin e veturave, pjesëve të ndërrimit (pjesëve rezervë) të aprovuar dhe të publikuar nga ana e KRPP-së*", ekspertja shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues me dt. 06 prill 2017, përmes letrës standarde kërkesë për informata mbi tenderin jo noramalishë të ulët, ka kërkuar nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë sqarim ku thuhet: ne konsiderojmë që tenderi i juaj është jo normalisht i ulët në krahasim me objektin e kontratës. Komisioni vlerësues dyshon se ju keni ofruar çmime jo normalisht të ulëta ne disa pozicione dhe dyshohet se ju mund ti kryeni shërbimet me çmimet e ofruara në ofertë, veçanërisht të pozicionet:

A. Servisimet e rregullta sipas planit ne çdo 10 000km të kaluara, si dhe pozicioni
C. Riparimi dhe ngjyrosja.

Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë me dt. 07 prill 2017, i kthen përgjigje autoritetit kontraktues ku ndër të tjera thuhet: deklaroj se në përpikëri do ti përmbahem çmimeve të ofruara në ofertë përkitazi me tenderin me titull: "**Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve zyrtare**" me nr. të prokurimit 612/17/438/221.

Nëse krahasohen vlera e parashikuar e kontratës me çmimin e ofruara nga operatorit ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës, rezulton se është çmim i ulët, mirëpo eksperti shqyrtues bazuar në nenin 61 i LPP-së, vlerëson se është drejtë dhe përgjegjësi e autoritetit kontraktues që të konsideron një tender të dorëzuar me çmim jo normalisht të ulët apo jo, që do të thotë se në rastin konkret autoriteti kontraktues respektivisht komisioni i vlerësimit të ofertave, tenderin e dorëzuar nga operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk e ka vlerësuar si çmim jo normalisht të ulët.

Sqarimi Nr. 3

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues ku thuhet: "*Ne me dt. 12.04.2017, me qëllim të verifikimit të pretendimeve tona ju kemi drejtuar me kërkesë për interpretim KRPP-së, dhe i njëjti organ me dt. 13.04.2017, përmes interpretimit të tij të dt. 13.04.2017, na ka konfirmuar se operatoret ekonomik të renditur me numër 1, 2 dhe 4 janë të papërgjegjshëm*", ekspertja shqyrtues sqaron se operatori ekonomik ankues ka parashtruar në KRPP, kërkesë për interpretim ku ndër të tjera thuhet: *në bazë të vlerësimit të ofertave autoriteti kontraktues ka rekomanduar me kontratë operatorin ekonomik të renditur me nr. 4 me vlerë prej 4, 918.50€, ndërsa operatoret tjerë ekonomik i ka shpallur të përgjegjshëm por të pa suksesshëm. Ju lutem që konform rregullave për tenderin jo normalisht të ulët, te na sqaroni se oferta e operatorit ekonomik numër 4, operatorit numër 2 dhe 1, a janë të përgjegjshëm apo jo konform formulës së paraparë në rregullat për tenderët jo normalisht të ulët. Vlen për tu theksuar se operatoret ekonomik të ranguar me numër 1, 2, 4, në ofertat e tyre kanë ofruar çmime jo normalisht të ulët.*

KRPP-ja për mes shkresës elektronike (e-malit) i kthen përgjigje operatorit ekonomik ankues ku ndër të tjera thuhet: nga vlera e parashikuar e projektit si që ju na shkruani se ishte 124,000.00€, ndërsa ofertat në fjalë që ju i atakoni dhe pretendoni se në total, po ashtu edhe në shumë pozicione kanë çmime jo normalisht të ulëta si që janë oferta më totale (51,027.82€, 51,923.63€ dhe 49,818.50€), konsiderojmë se edhe sipas Rregullave për çmime jo normalisht të ulëta sipas nenit 3.1 të këtyre Rregullave duhet të trajtohen si çmime jo normalisht të ulëta.

Si do qoftë, pavarësisht Rregullave për çmime jo normalisht të ulëta, sipas asaj që ju na shkruani, për pozicionet e këtyre tre ofertuesve (1,2 dhe 4), ku për secilin keni specifikuar se për disa pozicione në ofertat e tyre kanë ofruar çmime të cilat janë shumë të ulëta se çmimet reale të tregut dhe nëse për ato çmime të atyre pozicioneve ofroni dëshmi të AK, se janë jo normalisht të ulëta dhe jo reale të tregut, KRPP konsideron se AK duhet që gjithsesi ti verifikoj sepse, ***se a janë çmime të tregut apo jo sipas RrUOPP neni 4, janë ne përgjegjësi të AK-së***, dhe ato ofertat ti trajtojnë si oferta me çmime jo normalisht të ulëta si që përcaktohet në Rregullat për çmime jo normalisht të ulëta neni 4.2.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues

Gjatë analizimit të dosjes së tenderit dhe procedurës së zhvilluar për aktivitetin e prokurimit **"Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve zyrtare"** me nr. të prokurimit 612/17/438/221, i propozon panelit shqyrtues që ankesën e operatorit ekonomik ankues **N.T.P. "UNIVERZAL COMERC"** me seli në Fushë Kosovë, ta aprovoj si pjesërisht të bazuar, ndërsa të aprovoj vendimin e autoritetit kontraktues njoftimin për dhënie të kontratës, të dt. 11 prill 2017.